



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN / MUNICIPALITY OF LIPJAN



Drejtoria i Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Datë/Datum/ Date:	08.10.2024
Për/Za/For:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	z. Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës z. Lulzim Qerimi – Nënkyetar i Komunës z. Avni Jashari - Shef i Kabinetit të Kryetarit
Nga/Od/From	z. Rexhep Rexhepi - Drejtori i Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari
Lënda/Subjecat/Subject:	Raporti për muajin Shtator

I nderuar Kryetar Z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit të Bujqësisë dhe Pylltarisë për periudhën 01.09.2024 deri me 30.09.2024

RAPORTI PËR MUAJIN SHATOR - 2024

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

SEKTORI I BUJQËSIË

Drejtorati bujqësisë ka mbajtur takime të rregullta gjatë muajit shtator me staf dhe ka diskutuar rreth përfundimit të projektve, atyre që janë në proces dhe bashkëpunimeve të ardhshme me donator dhe organizata të cilat operojnë në Kosovë.

Gjatë muajit Shtator kemi filluar procedurat e prokurimit për projektin me Sera për listen pritëse dhe presim që ky projek të implementohet këtë vitë.

Projekti me Organizatën IADK është në proces dhe presim që shumë shpjet të implementohet në teren.

Gjithashtu gjatë muajit Shtator kemi pasur takime me organizatën Islamic Relief Kosova ku kemi diskutuar për mundësin e nënshkrimit të marrveshjeve ndërmjet Komunës dhe Organizatës për ty projekte me Sera me sipërfaqe 50m² dhe Motokultivatorë, projekt ky që planifikohet të realizohet gjatë këtij viti.

Me organizatën e QATAR CHARITY jemi në proces të hapjes

Punimet janë duke vazhduar në zhavorimin e rrugëve fushore, deri më tani kemi zhavoruar rreth 10km rrugë të kategoris së IV.

Jemi duke vazhduar me trajtimin e qenëve endacak në tër teritorin e Komunës së Lipjanit, pavarisht numrit të madhë të qeneve endacak që po operojne ne teritorin e Komunës ne me të gjitha kapacitetet jemi duke intervenuar në secilen lagje dhe fshatë.

Komisioni në Kuader të drejtoratit të bujqësisë është duke dalur në teren duke bërë verifikimin e secilit mjet që është subvencionuar që nga viti 20/ deri më tani.\

Gjithashtu Komisioni që është për të bërë vlerësimin e dëmëve të shkaktuara nga faktor të ndryshëm është duke dalur në teren sipas kërkesav.